



## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore *Hashim Thaçi, Bashkim Smakaj, Fadil Fazliu, Isni Kilaj dhe Hajredin Kuçi*, më 14 janar u bë publike se z. Smakaj u vetëdeklarua i pafajshëm më 3 janar. Rregullorja e Procedurës dhe e Provave përcaktonte se i akuzuari ka 30 ditë nga paraqitja e parë të pranojë fajësinë ose të vetëdeklarohet i pafajshëm në lidhje me secilën akuzë të paraqitur në aktakuzën e konfirmuar. Nëse i akuzuari nuk e bën këtë brenda kësaj periudhe, gjykatësi i procedurës paraprake automatikisht bën deklarin "i pafajshëm" në emër të të akuzuarit. Gjykatësja e Procedurës Paraprake kishte caktuar 7 janarin si afat deri në të cilin të akuzuarit të deklaroheshin në lidhje me fajësinë ose pafajësinë.

Në çështjen gjyqësore për krime lufte *Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi*, më 13 janar, Trupi Gjykses urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, duke konstatuar se për të dy të akuzuarit vazhdon të ekzistojë rreziku se do të pengojnë ecurinë e procesit dhe/ose të kryejnë vepra penale të tjera.

Trupi Gjykses mban parasysh se në këtë fazë të procesit emrat dhe të dhënat personale të disa dëshmitarëve tejet të cenueshëm janë nxjerrë dhe do të vazhdojnë të nxirren për të akuzuarit dhe, rrjedhimisht, do të bëhen të njohur për një numër të madh personash. Kjo, nga ana e vet, shton rrezikun që informacioni i ndjeshëm në lidhje me dëshmitarët të bëhet i njohur për publikun përpara se këta dëshmitarë të japin dëshmi. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses gjykon se lirimi i një të akuzuari që zotëron informacion të ndjeshëm nuk do të ndihmonte mbrojtjen efektive të dëshmitarëve që ende nuk kanë dëshmuar.

Në lidhje me sjelljen e z. Selimi në objektin e paraburgimit, Trupi Gjykses rikujton konstatimin e vet se duket se z. Selimi nxori informacion konfidencial për palë të treta të paautorizuara. Kjo sjellje mbështeti dhe përforcoi konstatimin e Trupit Gjykses se lirimi i z. Selimi përbën rrezik të pengimit të ecurisë së procesit.

Këtë javë, tre dëshmitarë dhanë dëshmi në gjykatë në këtë çështje gjyqësore. Uiliam Guduin (William Goodwin) dha dëshmi si ekspert për aspekte lidhur me identifikimin përmes ADN-së. Dëshmitari i dytë, Sokol Dobruna, dha dëshmi përmes videolidhjes dhe pati ndihmën e një avokati kujdestar gjatë dhënies së dëshmisë. Trupi Gjykses përshtati orarin e seancës gjatë dhënies së dëshmisë, për të mos mbingarkuar dëshmitarin, si dhe u kërkoi palëve t'i bënin pyetjet në një mënyrë që ndihmonte kujtesën e dëshmitarit dhe të bënin sa më pak pyetje përsëritëse ose sugjестive. Në fund, palët u pajtuan që deklaratat e mëparshme të këtij dëshmitari të pranohen si prova në vend të dhënies së dëshmisë në gjykatë. Dëshmitari i tretë dha dëshmi përmes videolidhjes me masa mbrojtëse. Sipas përmbledhjes së ZPS-së, anëtarë të armatosur të UÇK-së arrestuan dëshmitarin në 1999 dhe e çuan në një vendndalim ku u keqtrajtua.





Seanca e ardhshme në këtë çështje gjyqësore është caktuar për të hënë, 20 janar, në orën 9:00 paradite.

Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, më 10 janar, Paneli i Gjykatës së Apelit miratoi pjesërisht një kërkesë të Mbrojtjes për të urdhëruar Prokurorinë që të nxjerrë për Mbrojtjen të gjitha deklaratat dhe dëshmitë e një dëshmitari të caktuar, dëshmia e të cilit, sipas z. Shala, përfshinte prova relevante për argumentet mbrojtëse të z. Shala. Mbrojtja kishte kërkuar nga Dhoma Apelit që të konstatonte se Prokuroria nuk kishte përmbushur detyrimin për nxjerrje të materialit dhe të merrte parasysh këtë gjatë vlerësimit në apel të argumenteve të z. Shala se gjykimi i tij ka qenë i padrejtë.

Paneli i Apelit konstatoi se Prokuroria nuk kishte përmbushur në kohë detyrimin për nxjerrje të materialit në lidhje me këtë dëshmitar. Megjithatë Paneli rikujtoi se, si rregull, apelet ndaj aktgjyqimeve nuk janë mënyra e duhur për të paraqitur shkelje në nxjerrjen e materialit të identifikuar vetëm gjatë procesit të apelit, sepse ato normalisht përqendrohen në kundërshtime ndaj konstatimeve të bëra nga një trup gjykues i shkallës më të ulët. Paneli rikujtoi se këtu bëhet fjalë për aspektin nëse Mbrojtja mund të vërtetojë se kjo shkelje në nxjerrjen e materialit i shkaktoi dëm z. Shala. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykues theksoi se Mbrojtja i ka dorëzuar tashmë Panelit të Apelit një mocion më vete që aktualisht është duke u shqyrtuar dhe në të cilin trajtohen aspektet përkatëse lidhur me dëmin dhe relevancën e provave në fjalë.

Javët e fundit ka pasur komente në lidhje me kushtet e paraburgimit. Dua të shfrytëzoj rastin të sqaroj se objekti i paraburgimit i DHSK-së monitorohet nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (NNKK), i cili kryen inspektime të rregullta, të palajmëruara dhe të pavarura në objektin e paraburgimit për të këqyruar respektimin nga njësia e paraburgimit të të drejtave të njeriut, së drejtës ndërkombëtare dhe të standardeve të pranuarra të trajtimit. Gjithashtu, edhe Avokati i Popullit i DHSK-së kryen inspektime të rregullta për mbikëqyrjen e kushteve të paraburgimit.

